



REPUBLIKA E KOSOVËS \* REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit \* Opština Prizren  
Prizren Belediyesi  
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine  
Belediye Başkanı

01 Nr. 548/24 Dt. 09.09.2024



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja b, d dhe g të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) neni 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, neni 23 të Rregullores MF –Nr-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, pas kërkesës së Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M Për themelimin e Ekipit monitorues

1. Themelohet dhe emërohet Ekipi për monitorimin e implementimit të projekteve përfituese për OJQ sipas thirrjes publike nga fushat sociale në komunën e Prizrenit, për vitin 2024. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:
  - 1.1. Mimoza Selimaj,
  - 1.2. Albulena Pulaj,
  - 1.3. Arsim Hasani.
2. Detyrat e Ekipit për monitorimin e implementimit të projekteve përfituese për OJQ sipas thirrjes publike nga fushat sociale në komunën e Prizrenit për vitin 2024, të përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, janë të caktuara në Rregulloren MF –Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe ligjet dhe aktet të tjera nënligjore që e rregullojnë këtë lëmi.
3. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
4. Obligohet Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ekipi i lartcekur për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës  
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,
  - Ekipit të lartcekur,
  - Arkivës së Kryetarit.

